



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:260609

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05396789

**C.nr.781/2022**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**, gjyqtari Besmir Juniku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D.H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. D.M nga Prizreni, kundër të paditurës E, me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim i dëmit, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë **29.02.2024** merr këtë:

**A K T V E N D I M**

Padia e paditësit D.H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, në lidhje me këtë çështje juridike **KONSIDEROHET E TËRHEQUR**.

**A r s y e t i m**

Paditësi D.H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, përmes të autorizuarit të tij Av.D.M, në këtë gjykatë kanë parashtruar padi kundër të paditurës E me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim i dëmit.

Gjykata me Aktvendimin C.nr.7781/2022 të datës 24.03.2023 e ka ftuar paditësin që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh ta paguaj taksën gjyqësore për padinë e parashtruar, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e paguan në afatin e lartcekur, do të konsiderohet se ka bërë tërheqjen e padisë.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa se i autorizuari i paditësit me datë 04.04.2023 e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, ndërsa nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore të kërkuar për padinë e parashtruar.

Sipas nenit 253 par. 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se: *“253.5 Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”*

Duke marr parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësi nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për padinë e parashtruar, brenda afatit të përcaktuar, ndërsa nuk ekzistojnë kushtet për lirim të tij nga pagesa e së njëjtës, gjykata ka vendosur si në

dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 253 par. 5, lidhur me nenin 387 par. 1 pika c) të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**  
**C.nr.781/2022, datë 29.02.2024**

**Gj y q t a r i**  
**Besmir Juniku**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.